

STATUTI

I SHOQËRISË “SMART AI” SH.P.K

Në bazë të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, statuti i shoqërisë përgatitet si më poshtë:

NENI 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË

Emri i shoqërisë është **SMART AI Sh.p.k.** Shoqëria është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar që ushtron veprimtarinë e saj sipas Ligjit nr. 9901/2008.

NENI 2

SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë **SMART AI sh.p.k.** është në adresën: Durana Tech Park, Rruga Ahmet Zogu, nr. pasurisë 336, ZK 3852, njësia administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak, kodi postar 2013.

NENI 3

KOHËZGJATJA

“Kohëzgjatja e shoqërisë është e pakufizuar. Shoqëria fiton personalitet juridik në momentin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria ushtron veprimtari në fushën e teknologjisë së informacionit, si vijon:

- a. **Dizenjim software-i**, pa u kufizuar në analizën e kërkesave të sistemeve *software* dhe projektimin e arkitekturës së këtyre sistemeve;
- b. **Zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemeve software**, pa u kufizuar në programimin e sistemeve *software*, kodimin, instalimin, integrimin, mirëmbajtjen e të gjithë komponentëve;
- c. **Testimi i software-it**, pa u kufizuar në testimin e funksionaliteteve, performancës, problemeve të kodit dhe sigurisë së sistemit *software*;
- d. **Projektimi dhe zhvillimi i sistemeve të komunikimit**, pa u kufizuar në analizën, planifikimin, projektimin, zbatimin, vënien në punë dhe mirëmbajtjen e sistemeve të komunikimit të rrjetit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit (LAN/WAN/WLAN/MAN/SAN/CAN);
- e. **Projektimi dhe zhvillimi i sistemeve të sigurisë**, pa u kufizuar në analizën e kërkesave të

Statuti i Shoqërisë

sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimi dhe konfigurimi i komponentëve, zbatimi, testimi dhe mirëmbajtja e sigurisë së sistemeve dhe produkteve;

- f. **Zhvillimi i sistemeve të migracionit**, pa u kufizuar, transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një të re dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit;
- g. **Analiza e sistemeve me sasi të dhënash**;
- h. **Konsulencë për inovacion**. Konsulencë për përdorimin e teknologjisë së informacionit për qëllime të inovacionit të proceseve të biznesit me zhvillimin e kërkesave teknike për sistemet e informacionit dhe *software*;
- i. **Konsulencë për sigurinë e informacionit**. Konsulencë për mbrojtjen teknike dhe kriptografike të informacionit;
- j. **Konsulencë në auditime, operacione, menaxhim, mbështetje e përdoruesve, trajnime dhe konsulencë për auditime të teknologjisë së informacionit për sistemet *software***;
- k. **Kërkime në fushën e komunikimit**;
- l. **Kërkime në fushën e zhvillimit të programeve inovative**. Kërkimi dhe zhvillimi nënkupton aktivitete krijuese dhe sistematike të ndërmarra për të rritur njohuritë dhe për të krijuar aplikime të reja të njohurive të disponueshme.
- m. **Kërkimi dhe zhvillimi në fushën e robotikës**. Projektimi, kërkimi, testimi i aktiviteteve që përfshijnë teknologjitë robotike, pajisjet dhe sistemet që përdorin sisteme të kompjuterizuara kontrolli.
- n. **Aktivitete në fushën Cloud Computing**. Kërkime në *Cloud Computing* dhe vlerësimin e rrezikut të migrimit të shërbimeve *on-premises* drejt shërbimeve *Cloud*;
- o. Veprimtari të tjera në fushën e teknologjisë së informacionit.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë **SMART AI sh.p.k.** është 100.000 (njëqind mijë) Lekë, i plotësisht i nënshkruar dhe i paguar.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është si vijon:

- **Z. Ted LIKAJ**, i biri i Gentian dhe Marsela, lindur në Tiranë më 03/06/2003, dhe banues në Tiranë, me numër identifikimi personal K30603052F, ortaku themelues, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë totale 100.000 (njëqind mijë) Lekë, që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të rritet ose të zvogëlohet sipas dispozitave ligjore dhe vendimeve të organeve kompetente të shoqërisë.

NENI 6

DERDHJA E KUOTAVE TË KAPITALIT

Statuti i Shoqërisë

Kuotat e kapitalit themeltar do të derdhen nga ortaku në llogarinë bankare në emër të shoqërisë. Të gjitha derdhjet e kuotave do të regjistrohen në kontabilitetin e shoqërisë sipas rregullave dhe standardeve të kontabilitetit në fuqi.

NENI 7

FITIMET E SHOQËRISË

Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakut të saj. Asambleja e Përgjithshme vendos për shpërndarjen ose investimin e fitimeve në përputhje me ligjin, duke përcaktuar edhe mënyrën dhe afatet e shpërndarjes.

NENI 8

PASURIA DHE TË DREJTAT E SHOQËRISË

Shoqëria SMART AI sh.p.k. është përdoruese dhe mbajtëse e pasurisë së krijuar. Ajo ka të drejtë të marrë dhe të ushtrojë çdo të drejtë tjetër, materiale ose jomateriale, përfshirë të drejtën e shfrytëzimit dhe shitjes së pasurisë së krijuar të palëve të treta, në përputhje me ligjin.

NENI 9

REGJIMI I PRONËSISË DHE PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE

Shoqëria SMART AI sh.p.k. vepron në kuadër të pronësisë private dhe është përgjegjëse për të gjitha detyrimet dhe të drejtat e saj brenda kufirit të kapitalit të shoqërisë. Ortakët e shoqërisë janë të përgjegjshëm për rreziqet e aktivitetit të saj vetëm brenda limitit të kapitalit themeltar të investuar.

NENI 10

DREJTIMI DHE MENAXHIMI I SHOQËRISË

Detyrimet dhe kompetencat e ortakëve, të mbledhur në Asamblenë e Përgjithshme, përfshijnë të gjitha ato të parashikuara nga ligji, si dhe të përcaktuara në këtë statut.

Ndër detyrat dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme përfshihen, pa kufizim:

1. Ndryshimi i Aktit Themelues dhe i Statutit të shoqërisë;
2. Miratimi i buxhetit vjetor, veprimtarisë së administrimit, inventarit dhe bilancit të llogarisë vjetore;
3. Emërimi dhe shkarkimi i administratorëve, ortakë dhe jo-ortakë, si dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tyre, pa kërkesën e një shpjegimi për shkarkim;
4. Miratimi i huave dhe garancive;
5. Miratimi i tarifave për shërbimet që kryen shoqëria;
6. Përcaktimi i vulës dhe markës së shoqërisë;

Statuti i Shoqërisë

7. Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
8. Mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të veprimtarisë së shoqërisë;
9. Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të veprimtarisë së shoqërisë;
10. Vendimi për krijimin ose mbylljen e filialeve të shoqërisë;
11. Vendimi për riorganizimin ose shpërbërjen e shoqërisë;
12. Vendimi për fillimin ose zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje ligjore ku shoqëria është palë;
13. Emërimi dhe shkarkimi i likuidatorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar ose të konsulentëve të tjerë, persona fizikë ose juridikë;
14. Vendimi për ndarjen ose anulimin e kuotave të shoqërisë;
15. Miratimi dhe ndryshimi i rregullave të procedurës për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme;
16. Vendimi për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të shoqërisë;
17. Vendimi për shitjen e kuotave të shoqërisë;
18. Vendimi për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji ose nga statuti;
19. Marrja e çdo vendimi tjetër që nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër të shoqërisë.

NENI 11

THIRRJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme mbledhet pas njoftimit të dërguar nga administratori tek ortakët, me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, dhe duhet t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para datës së parashikuar për mbledhjen.

NENI 12

VENDIMET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me formë të shkruar.

Procesverbalet e vendimeve dorëzohen tek administratori, i cili i regjistron në regjistrin e vendimeve, që ruhet në selinë ligjore të shoqërisë nën kujdesin e administratorit.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme mund të merren edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 13

ADMINISTRATORI I SHOQËRISË

Administratori i shoqërisë është Z. Ted Likaj, me numër identifikimi personal K30603052F, i cili do të ushtrojë të gjitha veprimtaritë e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë duke zbatuar

politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Administratori emërohet për një mandat prej 5 (pesë) vitesh duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me të drejtën për t'u rizgjedhur, nëse Asambleja e Përgjithshme nuk vendos shkarkimin e tij para përfundimit të mandatit, ose në rast dorëheqjeje sipas procedurave të ligjit.

Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë edhe më shumë se një administrator, të cilët mund të jenë me çdo shtetësi. Në rast emërimi të një ose më shumë administratorëve, të gjithë administratorët janë përgjegjës, veç e veç ose së bashku, për përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të parashikuara nga ligji.

NENI 14

DETYRAT E ADMINISTRATORIT

Administratori kryen detyrat e ngarkuara nga ortakët e shoqërisë në këtë statut, si dhe të gjitha detyrat e parashikuara dhe të përcaktuara nga ligji. Midis këtyre detyrave përfshihen, pa kufizim:

1. Të veprojë dhe të nënshkruajë në emër të shoqërisë;
2. Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara nga ligji dhe nga statuti, përfshirë përgatitjen e rregullores së brendshme të shoqërisë dhe planin vjetor të biznesit për vitin financiar, i cili miratohet nga Asambleja e Përgjithshme; të administrojë punësimet, pagat, pushimet, masat disiplinore dhe kërkesat për dorëheqje nga puna;
3. Të përgatisë dhe të prezantojë para Asamblesë së Përgjithshme raportet mbi aktivitetin e shoqërisë dhe bilancin e mbylljes së vitit financiar të kaluar, sipas ligjit;
4. Të mbajë në rregull regjistrin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme;
5. Administratori (ose administratorët) është përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe të tretëve për shkeljet e ligjit ose të normave të statutit gjatë ushtrimit të kompetencave të tij;
6. Të kryejë të gjitha aktivitetet e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
7. Të përfaqësojë shoqërinë ndaj të tretëve;
8. Të caktojë përfaqësues të shoqërisë me prokurë të posaçme ose të përgjithshme, duke përcaktuar qartë objektin, kufijtë dhe afatin e vlefshmërisë së prokurës, në përputhje me këtë statut dhe legjislacionin në fuqi.
9. Të mbajë përgjegjësi për ruajtjen dhe saktësinë e dokumenteve dhe librave të llogarive të shoqërisë;
10. Të kryejë regjistrimin dhe dërgimin e të dhënave të nevojshme të shoqërisë tek Qendra Kombëtare e Biznesit;
11. Të raportojë Asamblesë së Përgjithshme për realizimin e politikave tregtare dhe aksioneve të veçanta të shoqërisë;
12. Të emërojë likuidatorë dhe konsulentë për çështjet e shoqërisë;
13. Të administrojë shoqërinë me korrektesë dhe vëmendje;

Statuti i Shoqërisë

14. Të kontraktojë marrëveshje me të tretët brenda objektit të aktivitetit dhe kompetencave të përcaktuara;
15. Të zbatojë rregulloren e brendshme të shoqërisë;
16. Të përgjigjet për dëmet e shkaktuara shoqërisë nga veprimet e tij;
17. Të paguhet për punën që kryen sipas marrëveshjeve me ortakun themelues;
18. Të informohet dhe të bëjë propozime për përmirësimin e veprimtarisë së shoqërisë;
19. Të kryejë të gjitha aktivitetet bankare të lidhura me llogarinë e shoqërisë;
20. Të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme sipas Neneve 12 dhe 13 dhe dispozitave të ligjit, kur nuk është përfshirë ndryshe në statut.

NENI 15

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË

Shoqëria ka të drejtë:

1. Të kryejë veprimtari në përputhje me objektin e saj të aktivitetit;
2. Të sigurojë pasurinë e saj;
3. Të marrë kredi në Lekë ose valuta të huaja nga bankat vendase ose të huaja në përputhje me ligjin;
4. Të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi, për detyrimet tatimore dhe të tjera;
5. Të investojë në territorin e Republikës së Shqipërisë me të ardhurat e realizuara gjatë ushtrimit të aktivitetit;
6. Të punësojë punonjës vendas ose të huaj sipas nevojës së veprimtarisë.

Shoqëria ka për detyrë:

1. Të sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;
2. Të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;
3. Të sigurojë punonjësit e saj;
4. Të përmbushë detyrimet fiskale dhe sociale ndaj shtetit, si dhe detyrimet kontraktore ndaj çdo pale;
5. Të respektojë standardet dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

NENI 16

RAPORTET EKONOMIKE DHE FINANCIARE TË SHOQËRISË

I gjithë aktiviteti i shoqërisë, në realizimin e objektit të saj, pasqyrohet në pasqyrat financiare.

NENI 17
MBAJTJA E DOKUMENTACIONIT FINANCIAR

Në selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në bazë të të cilit, brenda datës 31 Mars të çdo viti dorëzohen pasqyrat financiare (bilanci kontabël).

NENI 18
VITI FINANCIAR

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 19
LLOGARITË BANKARE

Shoqëria mund të ketë një ose më shumë llogari bankare në një nga bankat e nivelit të dytë.

NENI 20
DISPOZITA TË VEÇANTA

Shoqëria ka vulën e saj dalluese dhe mund të ketë një markë tregtare.

NENI 21
TRASFORMIMI I SHOQËRISË

Shndërrimi i shoqërisë **SMART AI sh.p.k.** në një shoqëri të tipit tjetër mund të realizohet me vendim të ortakut themelues, në përputhje me procedurat dhe dispozitat ligjore në fuqi.

NENI 22
SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Shpërbërja e shoqërisë mund të ndodhë për shkaqet e parashikuara në Nenin 99 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, si dhe për arsyet e mëposhtme:

- Humbja e kapitalit të shoqërisë;
- Pamundësi për ushtrimin e veprimtarisë;
- Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Statuti i Shoqërisë

Në këto raste, Asambleja e Përgjithshme cakton mënyrën e likuidimit dhe emëron një ose më shumë likuidatorë, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë deri në dorëzimin tek personat përkatës, dhe për likuidimin në radhë të parë të detyrimeve ndaj palëve të treta.

Në rast se fondet janë të pamjaftueshme për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkojë ortakëve themelues derdhjen e plotë të kuotave që u takojnë.

NENI 23

RREGULLIMI LIGJOR PËR ÇËSHTJET E PAPËRCAKTUARA

Çdo çështje që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut do t'i referohet legjislacionit shqiptar në fuqi, si dhe ndryshimeve të mëvonshme të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, në formën e aktit publik.

NENI 24


KOPJET E STATUTIT

Ky statut përgatitet në 4 (katër) kopje, të nënshkruara rregullisht nga të gjithë ortakët.

ORTAKE THEMELUES TE SHOQERISE

SMART AI SH.P.K

Ted Likaj



Datë: 08/01/2026